



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:040231

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05371951

A.nr.319/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditëses F..P.. me vendbanim në P., kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve – Departamenti i Pensioneve, për shkak të anulimit të vendimit, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 06.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses F..P.. me vendbanim në P., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit Nr.1427 të datës 20.01.2023 të marrë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve– Departamenti i Pensioneve.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me praninë e të autorizuarës së palës paditëse, praninë e palës së paditur dhe praninë e ekspertës mjekësore nga QKUK, Dr.H.. G..-Neurologe etj.

Paditësja me padinë e datës 14.02.2023 duke kërkuar anulimin e vendimit të kontestuar, për njohjen e kompensimit për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Paditësja është duke e realizuar këtë kompensim në shkallë të dytë, por kërkon realizimin për në grupin e parë. I propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadia e paditëses si e bazuar dhe anulohet vendimi i kontestuar i të paditurës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e paditëses deklaroi: *“Mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke i propozuar gjykatës aprovimin e padisë si të bazuar dhe anulimin e vendimit të atakuar me padi”*.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke i propozuar gjykatës aprovimin e padisë si të bazuar dhe anulimin e vendimit të atakuar me padi”*.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 19.06.2023 ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pabazuar kërkespadinë e paditësit. Dhe se paditësja nuk i plotëson kushtet gjegjësisht nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për përmbushjen e kriterëve për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Andaj i propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditëses në tërësi si e pabazuar dhe mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e të paditurës deklaroi: *“Pranë përgjigjes në padi dt.19.06.2023, po ashtu ekspertizën e kemi pranuar me kohë dhe ndaj të njëjtës nuk kam vërejtje dhe as pyetje për ekspertin prezent dhe mbi këtë bazë i propozoj gjykatës që padia e paditëse të refuzohet në tërësi si e pa bazuar”*.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Pranë përgjigjes në padi dt.19.06.2023, po ashtu ekspertizën e kemi pranuar me kohë dhe ndaj të njëjtës nuk kam vërejtje dhe as pyetje për ekspertin prezent dhe mbi këtë bazë i propozoj gjykatës që padia e paditëse të refuzohet në tërësi si e pa bazuar”*.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi numër 1427 i datës 20.01.2023, Aktgjykimi i kësaj gjykate në shenjën A.nr.2202/20 i dt. 02.11.2022, deklarata nën betim me numër 2381/18 dt. 26.11.2018, ekspertiza mjekësore e dt. 28.12.2023.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Gjykata gjeti se me vendimin e kontestuar paditëses i ishte refuzuar ankesa kundër vendimit të organit të shkallës së parë me të cilin paditësit i ishte refuzuar njohja e së drejtës në pension paraplegjik dhe tetraplegjik.

Duke ju referuar propozimit të përfaqësueses së paditëses, gjykata me Aktvendimin A.nr.319/23 të datës 06.12.2023, e me qëllim të marrjes së ekspertizës relevante mjekësore për të cilën gjykata nuk ka njohuri profesionale, kishte caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore përmes së cilës ekspertët përkatës mjekësor, pas ekzaminimit fizik mjekësor dhe shqyrtimit të raporteve mjekësore, do të përcaktonin nëse paditësja bën pjesë në ndonjërin nga grupet e personave paraplegjik dhe tetraplegjik dhe nëse e njëjta ka nevojë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë.

Tutje, ekspertët mjekësor me ekspertizën mjekësore të datës 28.12.2023 kishte konstatuar se paditësja ka dëmtime të përhershme por jo te plota, që nuk i përgjigjen shkallës së demtimeve të cilat mund të karakterizojnë në grupin e personave me paraplegji apo kuadriplegjipor (persona me dëmtime të përhershme dhe të plota), por pacientja i takon kategorisë së pacientëve me paafësi që i përgjigjet vlerës prej 60%. Tutje, ekspertja mjekësore Dr.H..G., në seancën e shqyrtimit kryesor deklaroi se: *“Pacientja aktualisht është poseduese e pensionit me nevoja të veçanta sondoma DAUN prandaj të vazhdohet ta merr pensionin për këtë kategori dhe nuk takon në grupin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik”*.

Duke marrë parasysh që gjykata nuk kishte njohuri mjekësore në lidhje me gjendjen shëndetësore të paditësit dhe kërkesave të tij, gjykata vendosi që ti falë besimin e plotë edhe ekspertizës mjekësore të hartuar nga ekspertët mjekësor, por edhe vlerësimeve të komisioneve mjekësore të të dy organeve të administratës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferëve dhe erdhi në përfundim të bazuar mirë se meqenëse paditësi nuk bën pjesën në asnjërin nga grupet e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, rrjedhimisht të njëjtës nuk mund ti njihet statusi i personit paraplegjik dhe tetraplegjik.

Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se qëndrimi i të paditurës dhe bazueshmëria ligjore e vendimit të atakuar është plotësisht e bazuar në prova dhe fakte si dhe në bazën ligjore.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë gjykatë.

Prandaj, gjykata vlerësoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësi. Mbi këto arsye thëniet e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.319/23, datë: 06.02.2024

G j y q t a r i

Numri i lëndës: 2023:040231
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05371951

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.